



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA**  
**KUVENDI I KOMUNËS –SUHAREKË**  
**MUNICIPAL ASSEMBLY- SUHAREKË**  
**SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA**



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e në mbështetje të nenit 14, paragrafi 1, lidhur me paragrafin 3, te Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 10/2019”, e konform nenit 6, pika 3, lidhur me nenin 8 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe neneve 15 dhe 29, pika 2 te Statutit të Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë ----- miratoi këtë:

**Projekt-V E N D I M**

**Neni 1**

**JEPET PËLQIMI-** për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër prej 1 (një) deri në 15, (pesëmbëdhjetë) vite të pronës së paluajtshme të Komunës, si vijon:

- 1.1 Lokalin afaristi i cili gjendet në rrugën “Brigada 123” në Suharekë, me sipërfaqe të përgjithshme prej **48.7m<sup>2</sup>**, sipas certifikatës së pronës **O-72116046-60-1-3-0** me numër të certifikatës **Nr. 350-2024**, të datës **08.02.2024**, zona kadastrale **Suharekë**, vendi i quajtura **“Gradina”** e evidentuar pasuri shoqërore në emër të Komunës së Suharekës, për ushtrimin e aktivitetit biznesor.
- 1.2 Lokalin afaristi i cili gjendet në rrugën “Brigada 123” në Suharekë, me sipërfaqe të përgjithshme prej **48.7m<sup>2</sup>**, sipas certifikatës së pronës **O-72116046-60-1-4-0** me numër të certifikatës **Nr. 470-2023**, të datës 08.02.2024, zona kadastrale **Suharekë**, vendi i quajtura **“Gradina”** e evidentuar pasuri shoqërore në emër të Komunës së Suharekës, për ushtrimin e aktivitetit biznesor.

**Neni 2**

**OBLIGOHET-**Drejtoria për shërbime pronësore juridike dhe kadastër dhe zyra e prokurimit që në bashkëpunim me komisioni për zbatimin procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës se paluajtshme të Komunës, afatshkurtër dhe afatgjatë, që të zhvilloj procedurat e ankandit publik, konform dispozitave të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te Komunës, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr. 10/2019” dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

**Neni 3**

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS –SUHAREKË**

01-Nr-\_\_\_\_\_  
Më datë\_\_\_\_\_

**Kryesuesi i Kuvendit**  
\_\_\_\_\_  
**Mr.ec Bexhet KUÇI**